



SYLLABUS I LËNDËS “DREJTËSIA KUSHTETUESE”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Drejtësia kushtetuese
Programi:	Juridik
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i IV, Semestri i VIII
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	Fakulteti Juridik
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Kadri Kryeziu
Të dhënat kontaktuese:	kadri.kryeziu@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	Lënda “Drejtësia Kushtetuese” trajton sigurimin e procesit të kushtetutshmërisë dhe ruajtjen e rendit kushtetues. Ky nocion përfshinë tërësinë e veprimeve institucionale dhe normative në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes të asaj se çfarë përbën rregullsi dhe stabilitet kushtetues. Andaj përmes kësaj lënde do të elaborohen institucionet dhe teknikat nëpërmjet të cilave sigurohet supremacia e Kushtetutës.
Qëllimi i lëndës:	Qëllimi kryesor i mesimdhënies se kësaj lënde është njohja e studentëve të studimeve bachelor me konceptet themelore të gjyqësisë kushtetuese, zhvillimi historik i gjyqësisë kushtetuese, sistemet e ndryshme të kontrollit kushtetues, fillim dhe zhvillimi i një procesi kushtetuese, juridiksionin kushtetues dhe politikat jurisprudenciale. Më tej, e rëndësishme është të sqarohen edhe Gjykatat Kushtetuese në përgjithësi, me theks të veçantë sistemi aktual i mbrojtjes kushtetuese në Kosovë, themelimi, veprimtaria dhe efektet e vendimeve kushtetuese. Aspekti teorik do të konkretizohet përmes elaborimit me raste studimore që kanë lidhmëri me çështjet kushtetuese që do të trajtohen në këtë lënd.
Rezultatet e të nxënit:	Në përfundim të ligjeratave në këtë lënd studentët duhet të jenë të aftë: -T'i kuptojnë dhe përvetësojnë konceptet bazë të drejtësisë kushtetutuese.

	<p>-Të përfitojnë njohuri sa i përket incimit të procesit kushtetues në mbrotjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.</p> <p>-E rëndësishme është që të kuptohet sistemi i mbrotjes kushtetues që aplikohet në Republikën e Kosovës dhe veqoritë që e shoqërojnë këtë sistem për dallim nga sistemet e tjera të mbrotjes kushtetuese që aplikohen në shtetet e tjera.</p> <p>-Njohuritë e gjeneruara nga kjo lëndë të arrijnë t'i materializojnë me sukses në praktikë në të ardhmen.</p>		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	1/15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	1/15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/15	15
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare	1	1/1	1
Detyra të shtëpisë	1	1/5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	2	1/11	22
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	1	1/8	8
Projektet, prezantimet ,etj	1	1/4	4
Totali			175 orë (7 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Metodologjia e mësimdhënies do të konsistojë në ligjërimitin e lëndës sipas metodës interaktive . Me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të lëndës dhe të mundësisë për ndërveprim më të madh në klasë, rekomadohet që studentët të lexojnë paraprakisht materialet për temën e cila do të diskutohet në orën pasuese. Studentët inkurajohen të parashtrojnë pyetje, komente dhe sugjerime gjatë ligjëratave si dhe të ngrisin edhe diskutime që kanë relevancë me temën e ligjërates.</p>		



Metodologjia e vlerësimit:	Vlerësimi me gojë dhe me shkrim: Pjesëmarrja dhe aktiviteti në ligjërata.....5% Pjesëmarrja dhe aktiviteti në ushtrime5% Punime seminarike 10% Vlerësimi final:80% <hr/> Totali:100%
Literatura	
Literatura primare:	1. Kadri Kryeziu, “Drejtësia kushtetuese, Prizren, 2021. 2. Sokol Sadushi, “Drejtësia kushtetuese në zhvillim”, Tiranë, 2012. 3. Visar Morina, “Gjyqësia kushtetuese”, Prishtinë, 2013.
Literatura shtesë:	1. Kristaq Traja, “Drejtësia kushtetuese”, Tiranë, 2000. 2. Vicki Jackson & Mark Tushnet, “Comperative Constitutional Law”, New York 2006. Kushtetuta e Republikës së Kosovës 3. Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës 4. Rregullorja e punës e Gjykatë Kushtetuese të Republikës së Kosovës 5. Kushtetuta e Shqipërisë.

Plani i dizajnuar i mësimi:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	Prezentim i programit të lëndës dhe metodologjisë së mësimdhënies	Prezentim i metodologjisë së mësimdhënies gjatë ushtrimeve
<i>Java e dytë:</i>	NOCIONI I DREJTËSISË KUSHTETUESE 1. Historiku i Drejtësisë Kushtetuese 2. Konteksti anglez 3. Konteksti amerikan 4. Rasti Merbury v. Madison – doktrina e rishikimit gjyqësor 5. Epërsia e kushtetutës	Përsëritje-Nocioni i drejtësisë kushtetuese dhe analizë e rastit Merbury v. Madison
<i>Java e tretë:</i>	HISTORIKU I DRJETËSISË KUSHTETUESE 1. Konteksti anglez 2. Konteksti amerikan 3. Konteksi evropian 4. Konteksti amerikano-latin	Përsëritje-Historiku i drejtësisë kushtetuese, llojet dhe karakteristikat e kontekstit anglez, amerikan, evropian dhe amerikano-latin

<p><i>Java e katërt:</i></p>	<p>KRAHASIMI I TEKNIKAVE TË DREJTËSISË KUSHTETUESE NË SISTEMET E SOTME 1. Shumëllojshmëria evropiane 2. Etapa e parë : pas Luftës së Parë Botërore 3. Etapa e dytë: Pas Luftës së Dytë Botërore 4. Etapa e tretë – pas rënies së komunizmit 5. Rreth Gjykatës Kushtetuese të Kosovës</p>	<p>Përsëritje-Etapat e zhvillimit të drejtësisë kushtetuese në përgjithësi dhe në veçanti në Kosovë</p>
<p><i>Java e pestë:</i></p>	<p>MODELET E DREJTËSISË KUSHTETUESE Klasifikimi i modeleve të kontrollit kushtetues</p>	<p>Përsëritje-Modelet e drejtësisë kushtetuese</p>
<p><i>Java e gjashtë:</i></p>	<p>PROCEDURAT ABSTRAKTE TË DREJTËSISË KUSHTETUESE 1. Kontrolli paraprak i normave të së drejtës 2. Kontrolli i mëpasshëm normave të së drejtës 3. Efekti i vendimeve</p>	<p>Rast studimi procedurat abstrakte të kontrollit kushtetues në Kosovë</p>
<p><i>Java e shtatë:</i></p>	<p>KARAKTERISTIKAT E DREJTËSISË KUSHTETUESE 1. Themelimi i Gjykatave Kushtetuese 2. Procedura e emërimit 3. Profesionalizmi 4. Statusi i Gjykatës dhe i gjyqtarëve Kushtetues</p>	<p>Përsëritje-Karakteristikat e drejtësisë kushtetuese</p>
<p><i>Java e tetë:</i></p>	<p>JURIDIKSIONI KUSHTETUES 1. Konfliktet që lidhen me shprehjen e vullnetit të popullit 2. Konfliktet që lidhen me ndarjen horizontale të pushteteve 3. Konfliktet që lidhen me ndarjen vertikale të pushteteve</p>	<p>Rast studimit-juridiksioni kushtetues</p>

<i>Java e nëntë:</i>	JURIDIKSIONI KUSHTETUES 1. Gjykimet për të drejtat themelore të njeriut 2. Konfliktet e drejtësisë politike	Rast studimi-gjykimet për të drejtat e themelore të njeriut
<i>Java e dhjetë:</i>	PROCESI KUSHTETUES 1. Kërkesa 2. Gjykimi 3. Diskutimi (deliberation) 4. Vendimi 5. Natyra juridike e efekteve të vendimeve 6. Pse vendimet e Drejtësisë Kushtetuese kanë karakter detyrues?	Përsëritje-procesi kushtetues. Analizë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	POLITIKAT JURISPRUDENCIALE 1. Vetëpërmbajtja 2. Aktivizimi 3. Kufizimi i Drejtësisë Kushtetuese 4. Rishikimi i rishikimit – paradoksi i Alf Rosit	Përsëritje-Politikat jurisprudenciale
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	NDIKIMI I DREJTËSISË KUSHTETUESE 1. Ndikimi mbi ligjvënësin 2. Ndikimi mbi ligjzbatuesin 3. Ndikimi mbi të drejtën ndërkombëtare 4. Ndikimi mbi autoritetet vendase që zbatojnë traktatet 5. Ndikimi mbi Kushtetutën 6. Ndikimi mbi të drejtat e njeriut	Përsëritje-Ndikimi i drejtësisë kushtetuese
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	GJYKATAT KUSHTETUESE E AUSTRISË, REPUBLIKËS FEDERALE GJERMANE, ITALISË DHE KËSHILLI KUSHTETUES I FRANCËS 1. Gjykata Kushtetuese e Austrisë 2. Gjykata Kushtetuese e Republikës Federale Gjermane 3. Gjykata Kushtetuese e Italisë	Analizë dhe diskutim rreth përbërjes dhe juriksionit të Gjykatës Kushtetuese të Austrisë, Republikës Federale Gjermane dhe Këshillit Kushtetues të Francës



	4. Këshilli Kushtetues i Francës	
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	GJYKATA KUSHTETUESE E SPANJËS, PORTUGALISË, SHQIPËRISË DHE E KOSOVËS 1. Gjykata Kushtetuese e Spanjës 2. Gjykata Kushtetuese e Portugalisë 3. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë 4. Gjykata Kushtetuese e Kosovës	Analizë dhe diskutim rreth përbërjes dhe juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese të Spanjës, Portugalisë, Shqipërisë dhe Kosovës
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Parapërgaditje për provim	Parapërgaditje për provim
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		
<i>Studentët janë të obliguar :</i> <ul style="list-style-type: none">• Studenti duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe njëkohësisht të jetë i vëmendshëm në orën mësimore.• Plagjiatura dhe fenomenet e ngjashme mashtruese do të ndëshkohen sipas akteve juridike në fuqi.• Të respektohet Kodi i Etikës për Studentët i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.		